

Vendim nr. 70 datë 05.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 05.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (F) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FRAN DASHI**

OBJEKTI: Gjykata Kushtetuese të shprehet nëse midis emisioneve investigative “Fiks Fare” në Top Channel dhe “Stop” në Tv Klan dhe neneve 21-226 të Seksionit të IV “Përgjimet” të Kodit të Procedurës Penale ka pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

A mund të merren si prova nga gjykatat shqiptare problemet që trajtojnë emisionet investigative “Fiks Fare” në Top Channel dhe “Stop” në Tv Klan, në raport me kërkesat e neneve 21-226 të Seksionit të IV “Përgjimet” të Kodit të Procedurës Penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 43, 124, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27-31 dhe 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Fran Dashi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) duke pretenduar se gjykatat e zakonshme marrin vendime për deklarimin fajtorë të shtetasve mbi bazën e provave që trajtojnë emisionet investigative të transmetuara në disa televizione publike, të cilat, sipas tij, kufizojnë pa ligj të drejtat e njeriut dhe shkelin parimin e barazisë dhe ndalimit të diskriminimit.

2. Në mbështetje të kërkesës ai ka paraqitur një vendim të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku nuk ka qenë as palë, as përfaqësues ligjor, me të cilin është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj një personi nën hetim, i akuzuar për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 259/2 dhe 25 i Kodit Penal, në procedimin penal të iniciuar mbi bazën e pamjeve filmike të publikuara nga emisioni investigativ “Stop” në Tv Klan.

II

Pretendimet e kërkuarit

3. **Kërkuesi** ka parashtruar në kërkesën e tij sa vijon:

- 3.1. Sipas dispozitave kushtetuese vetëm prokuroria dhe gjykatat mund të vlerësojnë ligjshmërinë e kryerjes së përgjimeve telefonike, ambientale etj., në respektim të neneve 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, kurse emisionet investigative ndërhyjnë në mënyrë arbitrare në problemet e gjyqësorit dhe privatësinë e qytetarëve shqiptarë. Në lidhje me problemet që trajtojnë emisionet investigative, nuk rezulton që ato të jenë ngarkuar me akte ligjore e nënligjore për të përgjuar pa leje të organeve kompetente.
- 3.2. Vendimet gjyqësore që bazohen në këto emisione investigative për kufizimin e të drejtave të shtetasve dhe i përdorin ato si provë, përbëjnë rast të pastër diskriminimi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

4. Kolegji vëren se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj, si dhe i nënshtrohet vetëm Kushtetutës. Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është ndër funksionet më të rëndësishme të kësaj Gjykate, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar, gjithashtu, se natyra e pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje dhe se, në përputhje me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, Gjykata e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimet nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Neni 131, pika 1, i Kushtetutës ka përcaktuar kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, dhe në shkronjën “f” të tij, që është edhe baza ligjore ku kërkuesi ka mbështetur këtë kërkesë, është parashikuar se ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

7. Kjo dispozitë kushtetuese është zbërthyer në ligjin nr. 8577/2000, që i njeh individit të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual për kundërshtimin e çdo akti që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese (neni 71), si dhe parashikon kriteret paraprake që duhet të përmbushen për paraqitjen e tij (neni 71/a). Sipas pikës 2 të nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, nëse përmbushen kriteret e parashikuara nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i tij, të cilat lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave dhe lirive kushtetuese, shterimin e të gjitha mjeteve juridike përkatëse dhe zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të aktit objekt ankimi, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore.

8. Kolegji, në mbështetje të sa më sipër, si dhe referuar objektit dhe shkaqeve të parashtruara në kërkesën në shqyrtim, vëren se çështjet e ngritura nga kërkuesi nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Gjykata nuk mund të vihet në rolin e organit që jep opinione

këshillimore dhe as nuk ka në kompetencë të vlerësojë në abstrakt ligjshmërinë ose përputhshmërinë, qoftë edhe me dispozitat procedurale penale, të veprimtarisë “mediatike” të personave fizikë/juridikë apo edhe veprimtarisë së organeve publike, nëse këto pretendime nuk ngrihen në nivel kushtetues, pra nuk përbëjnë çështje kushtetuese në kuptim të nenit 131, pika 1, të Kushtetutës.

9. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.